



Termat e referencës për MZHR

SISTEMI PËR MONITORIMIN E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK RAJONAL
TË BALANCUAR



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë Mars 2021

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ANALIZA SOCIO-EKONOMIKE RAJONALE

TERMAT E REFERENCËS SE SISTEMIT ELEKTRONIK

Studimi i vizibilitetit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë dhe dizajnimi i sistemit

DOKUMENTI U PUNUA NGA GRUPI PUNUES:

LEUTRIM GASHI, MENAXHER PROJEKTI
TOMOR CELA,

Përmbajtja:

1.1	Qëllimi.....	2-12
1.2	Shtrirja	2-13
1.3	Metodologjia	2-13
1.4	Koha e Implementimit.....	2-14
1.5	Akronimet dhe Shkurtesat.....	2-15
1.7	Kontaktet komunale:.....	2-17
1.8	Kontaktet institucionale:	2-18
1.9	Disa nga sistemet qe do te shkëmbejmë te dhënat janë:.....	0
1.9	Siguria.....	2
2.0	KARAKTERISTIKAT E SISTEMIT ELEKTRONIK PER ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK RAJONAL TE BALANCUAR.....	4
2.1	IMPORTIMI I TE DHENAVE.....	5
2.2	Ngarkimi i dokumenteve dhe i te dhenave	6
2.3	Metadata	7
	Menaxhimi i dokumenteve fizike.....	10
	Ruajtja dhe asgjesimi i dokumneteve elektronike	Error! Bookmark not defined.
	Kerkimi dhe gjetja e dokumenteve.....	11
	Transferimi	12
	Raportimi	14
	Fshirja, ndryshimi dhe zhvendosja e dokumenteve elektronike	15
	Integrimi.....	16
3.0	KERKESAT JOFUNKSIONALE	17
	Navigimi dhe shfrytezimi	17
	Ballina	17
	Perkrahja	18

1. Shkurtesat

Shkurtesat e përdorura në këtë dokument janë si vijon:

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ML	Ministritë e linjës
DPASER	Departamenti për Planifikim dhe Analiza Socio – Ekonomike Rajonale
DZHR	Departamenti për Zhvillim Rajonal
RZH	Rajon Zhvillimor
MZHSERB	Monitorimi i zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar
SMZHSERB	Sistemi për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar
ZHRB	Zhvillimi Rajonal i Balancuar

2. HYRJE

Zhvillimi rajonal si temë dhe fushë e zhvillimit, nuk është e re në Kosovë, ajo njihet që më herët, por në aspekt të shfrytëzimit më strukturor të fondeve të BE-së njihet që nga viti 2008.

Zhvillimi rajonal i balancuar, nënkupton uljen e dallimeve në aspekt të zhvillimit socio - ekonomik dhe ngritjes së cilësisë së jetës në rajone zhvillimore. Zhvillimi rajonal i balancuar nuk mund të arrihet pa ngritjen e kapaciteteve të rajoneve në mënyrë që të kenë një konkurrencë të mirëfilltë ndër rajonale. Është e nevojshme të ndërmerren masa për të ngritur konkurrencën ndër rajonale në mënyrë që të arrihen nivele më të larta të produktivitetit, punësimit dhe prosperitetit. Politika e zhvillimit të balancuar rajonal ndërhyr për të korigjuar pabarazitë mes rajoneve të ndryshme të një vendi dhe gjithashtu për ngritjen e standardit të jetesës në një nivel më të lartë me një normë të barabartë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), konfom detyrave dhe përgjegjësi të saj të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe Planin e Punës për vitin 2020, ka paraparë hartimin e termave të referencës për realizimin e studimit të vizibilitetit lidhur me monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar. Në kuadër të kësaj detyre, hyn edhe disajnimi apo përshkrimi i sistemit i cili do të ndërtohet nga MZHR dhe shfrytëzohet nga personat kompetent, për monitorimin dhe matjen e performances rajonale.

Hartimi i termave të referencës për studimin e vizibilitetit dhe dizajnimin e sistemit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar parqet pikënisje për ndërtimin e sistemit për monitorimin e zhvillimeve sociale dhe ekonomike të rajoneve zhvillimore. Ky sistem do të identifikoj të gjitha fushat relevante të zhvillim social dhe ekonomik mbi bazën rajonale, treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik si dhe përmes këtij sistemi do bëhet monitorimi në afate të rregulluara i zhvillimit ekonomik dhe social në rajone zhvillimore si dhe stimulimi, promovimi dhe menaxhimi i performancës rajonale, synim ky strategjik i MZHR-së.

3. Qëllimi

MZHR, ka finalizuar edhe Planin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020 – 2030, e cila është aprovuar në Qeveri.

MZHR tani veç ka përcaktuar edhe objektivat strategjike shumë vjeçare në fushën e zhvillimit rajonal në Kosovë. Pjesë e synimeve strategjike të MZHR-së, është edhe ndërtimi i një sistemi efikas të performancës rajonale. Nga viti 2017, kur MZHR është formuar si Ministri e re, ka hartuar dhe publikuar një numër të konsiderueshëm të dokumenteve analitike lidhur me pasqyrimin e zhvillimit rajonal të balancuar në Kosovë. Këto aktivitete, i ka realizuar mbi bazën e një bashkëpunimi të mirë që ka arritur ta realizojë më institucione të nivelit qendror (M.L dhe ASK) dhe lokal (komunat). Secilin vit, MZHR ka hartuar dhe publikuar të paktën dy (2) analiza: 1.)Analizën e investimeve kapitale dhe 2.) Analizën e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar (subvencione dhe grante për biznese). Mirëpo, raportimi dhe mbledhja e të dhënave, sistemimi i tyre dhe pasqyrimi nëpër rajone zhvillimore, në mungesë të një sistemi të avancuar elektronik, është bërë manualisht dhe në Excel.

Qëllimi i MZHR-së është pasqyrimin sa më i saktë dhe i drejtë i zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë, përmes trajtimit të çështjeve që edhe tejkalojnë kompetencat e komunave dhe që ndërlidhen me institucione tjera dhe me nivelin qendror. Zhvillimi socio – ekonomik rajonal i balancuar, në disa aspekte tejkalon kufijtë komunal të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, si dhe nuk ka të bëjë me çështje administrative të organizimit të niveleve të qeverisjes. Zhvillimi socio – ekonomik rajonal i balancuar, nuk kufizohet në nivelin e zhvillimit ekonomik lokal, por e tejkalon atë duke pasqyruar edhe zhvillimin e sektorëve dhe projekteve të zhvilluar në dy e më shumë komuna.

Monitorimi i zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, është një fushë e re, të cilën nuk e kanë zhvilluar më herët institucionet e nivelit qendror. Zhvillimi i këtij dokumenti, bëhet me qëllim të krijimit të një pikënisje të ndërtimit të një sistemi, të cilin MZHR do ta menaxhojë, ndërsa në të do të përfshihen si përdorues zyrtar lokal dhe qendror lidhur me përfshirjen e të dhënave. Përmes ndërtimit të një sistemi, me përmbajtje të dhënave të zhvillimeve sociale dhe ekonomike të rajoneve zhvillimore të cilat i promovon MZHR, do të ndikojë në balancimin e investimeve në rajone, si dhe pasqyrimin e saktë të fushave në të cilat kemi stagnim të zhvillimit dhe që duhet të angazhohemi më shumë për progres. Kjo, ka për qëllim edhe vënien në pah të pabarazive në aspekte të ndryshme të mirëqenës socio-ekonomike në të gjithë rajonet e Kosovës dhe të pasqyrimin të ndryshimeve me kalimin e kohës, duke i promovuar faktorët ndikues dhe ata që shihen si pengesë.

Qëllimi i këtij dokumenti, është që MZHR të inicojë procedurat dhe të kontraktojë një operator apo kompani e cila do të evidentojë të gjitha temat, fushat, treguesit dhe përcaktojë rrugën përmes së cilës MZHR do të sigurojë të dhënat e nevojshme për pasqyrimin e zhvillimeve sociale dhe ekonomike rajonale. Përmes pasqyrimin të saktë të

zhvillimeve socio – ekonomike, do të ndikohet edhe në orientimin e politikave strategjike dhe të investimeve të balancuara të ministrive të linjës në rajone zhvillimore. Studimi i vizibilitetit, përveç identifikimit të fushave, treguesve, metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, raportimit, duhet ti ofrojë MZHR-së edhe modelin e sistemit që duhet ndërtojë, si dhe me të gjitha elementet e efikasitetit që duhet ti ketë.

4. Metodologjia e hartimit të dokumentit

MZHR me vendimin Nr.183, të datës 14 Maj 2020, ka formuar Grupin Punues i përbërë prej pesë (5) anëtarëve i cili GP ka pas për qëllim hartimin e këtij dokumenti. Grupi Punues ka realizuar katër (4) takime konsultative punuese deri në finalizimin e dokumentit “Hartimi i termave të referencës për studimin e vizibilitetit për dizajnimin e sistemit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë”.

Bazuar në Vendimin nr. 183, GP ka marrë për bazë analizat dhe treguesit për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar të hartuara dhe publikuara në v.2019 si dhe synimet strategjike të MZHR-së që ndërlidhen me krijimin dhe zhvillimin e një sistemi efikas të menaxhimit të performancës rajonale. Gjithashtu DPASER me qëllim të rritjes së cilësisë së udhëzuesit ka zhvilluar takim konsultative me Departamente tjera relevante të Ministrive të Linjës si (MBPZHR-së dhe MZHE-së).

5. Termat e referencës për zhvillimin e studimit të vizibilitetit dhe dizajnimin e sistemit

Me qëllim të elaborimit më të detajuar të përmbajtjes dhe përshkrimit të procesit të zhvillimit të studimit dhe dizajnit të sistemit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, fillimisht janë përgatitur disa objektiva.

Objektivat të cilat MZHR synon ti arrijë përmes realizimit të studimit të vizibilitetit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë dhe dizajnimin e sistemit, janë si vijon:

1. Përmes realizimit të studimit të vizibilitetit lidhur me monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, MZHR synon t'i definojë të gjitha temat/aktivitetet (sociale dhe ekonomike) që mund të përbëjnë zhvillimet sociale dhe ekonomike rajonale dhe të cilat mund të maten e pasqyrohen në periudha të caktuara nga MZHR.
2. MZHR synon ta sigurojë një burim informacioni që do të mund ta shfrytëzojë në të ardhmen, se për realizimin e monitorimit të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, cilat janë temat e trajtimit dhe që mund të hynë në kuadër të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, fushat e trajtimit, cilët janë treguesit për matjen e zhvillimeve sociale dhe ekonomike rajonale, realizimin e proceseve për raportimin dhe mbledhjen e të dhënave/metodologjia e punës, akterët që duhet të përfshihen, një përshkrim për ndikimet e pritshme të dokumenteve analitike të

publikuara nga MZHR për pasqyrimin e rregullt të monitorimit të zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, etj. Të gjitha aktivitetet që do t'i përmbajë studimi dhe që i rekomandohen MZHR-së ti realizojë në të ardhmen, duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe duke respektuar fushë veprimtarinë e institucioneve tjera.

3. Sistemi elektronik do të zhvillohet për MZHR për matjen e zhvillimeve sociale dhe ekonomike mbi baza rajonale, duke i konkretizuar pastaj ato edhe nëpër njësi (komuna) apo çështje ma konkrete (fusha dhe sektor). Cila duhet të jetë përmbajtja e tij, kush mund të jenë përdoruesit dhe numri i tyre, siguria dhe mirëmbajtja, ndryshimet dhe modifikimet, dokumentimi i softuerit, në çfarë platforme duhet të zhvillohet, etj.
4. Të gjitha elementet që ndërlidhen me sistemin elektronik për monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar (performances rajonale) të paraqiten në një pjesë të veçantë e cila do të përdoret nga MZHR për kontraktimin e kompanisë që do ta zhvillojë këtë sistem.
5. Pas analizimit të gjitha çështjeve që ndërlidhen me monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, përcaktimin e treguesve që duhet përdorur, etj, MZHR të sigurojë një sistem efikas për matjen e zhvillimit socio – ekonomik/përformancës rajonale dhe pasqyrimin përmes publikimit të analizave socio – ekonomike apo dokumenteve tjera, në periudha të caktuara kohore (vjetore apo më të gjata).

Ofertuesi i cili do të realizojë këtë studim, duhet së paku të plotësojë dhe realizojë veprimet si vijon:

- Të jetë operator me përvojë në këtë fushë (së paku 3 vjeçare), me se paku tri (3) kontrata (ku tregohen, vlerat, datat, natyra dhe vendi i realizimit) për ofrimin e shërbimeve të ngjashme të realizuara në tri (3) vitet e fundit për institucione private apo publike, nga dita e fundit e publikimit të njoftimit për kontratë dhe të dëshmohet me referenca.
- Operatori, duhet të dëshmojë se ka kapacitete të mjaftueshme të resurseve njerëzore për ti kryer shërbimet, ekspert me kualifikime të larta:
 1. Të përfunduar shkollimin universitar - mastër, ofrimin e dëshmisë "Diplomës" nga fusha e teknologjise informative perkatesisht shkenca kompjuterike
 2. Të përfunduar shkollimin universitar - mastër, ofrimin e dëshmisë "Diplomës" nga fushat sociale dhe
 3. Nje ekspert të kete përfunduar shkollimin universitar bachelor ne ekonomi.
 4. Pesë (5) programerë qe kane të përfunduar shkollimin universitar bachelor apo shkollim të lincencuar profesional në fushën e (TI-së) zhvillimit të softuerëve .

5. Një dizajner i sistemit të kete përfunduar shkollimin universitar master ne dizajn. Ekspertët duhet të jenë edhe me përvojë pune në së paku dy (2) pune apo sherbime në fushat perkatese. Edhe për përvojën, të ofrohen dëshmitë: kontratat e punës/angazhimeve, e preferueshme edhe produktet.

- Operatori të ofrojë dëshmi lidhur me përshtatshmërinë ekonomike, dëshmi nga banka për qarkullimin për tri (3) vitet e fundit, jo më të vogël se 100,000.00 euro.
- Procesin e zhvillimit të sistemit, e udhëheq operatori, bashkë me procesin e konsultimit të dokumentit me përfaqësuesit institucional i caktuar nga MZHR.
- Sistemi per monitorimin e zhvillimit socio-ekonomik rajonal te ballancuar duhet të përmbajë përshkrimin e parametrave mbi të cilët do të ndërtohet sistemi informativ/elektronik (monitorimit), i cili po'ashtu duhet të mundësojë prezantimin vizual, ndërlidhjen me institucionet e përfshira, afatet e futjes së të dhënave, fushat e trajtuara, treguesit, sistemin e autorizimit të përdoruesve, llogaritjen e treguesve cilësor dhe sasior, etj.
- Gjatë procesit, MZHR, ruan të drejtën e paraqitjes së kërkesave shtesë, për përfshirjen e tyre në studimin e vizibilitetit apo dizajnimin e sistemit.

MZHR është përgjegjëse për të siguruar dhe ofruar në dispozicion:

- MZHR, do të ketë në dispozicion për operatorin, të gjithë dokumentacionin e hartuar dhe publikuar (në vitet 2018,2019,2020) dhe i cili do të paraqiste njërën nga burimet e informacionit, për krijimin dhe zhvillimin e sistemit.

Rezultatet e projektit:

- Operatori duhet të mbajë dy (2) prezantime ndaj MZHR-së, të produktit/studimit të cilin është duke e përgatitur, në mënyrë që tu jepet mundësia stafit të MZHR-së për propozimin e komenteve.
- Sistemi duhet të dorëzohet në MZHR në format elektronik dhe MZHR do te mbaje autoresine.

1.1 Qëllimi

Krijimi dhe dizajnimi i nje sistemi elektronik digjital për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë eshte mese i domosdoshëm ashtuqe te kemi nje pasqyre te qarte per zhvillimin e gjithembarshem ne nivel te Republikes se Kosoves.

Digjitalizimi i proceseve dhe shërbimeve ne nivel rajonal ka qenë një kohë të gjatë njëra nga kërkesat më të nevojshme si mënyrë e ofrimit e shërbimeve më efikase dhe ngritjes së cilësisë dhe raportimit te sakte dhe te detajuar. Është me rëndësi të veçantë që përveç mbledhjes se te dhënave ne rajonet e Kosovës te kemi edhe nje monitorim sa me te mire dhe te mund te orientojmë investimet dhe politikat strategjike te karakterit ekonomik ne rajonet e caktuara duke u bazuar ne te dhënat reale qe do na ofroj sistemi elektronik si dhe matja e performances.

Raporti i studimit te vizibilitetit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë dhe dizajnimi i sistemit ka per qellim krijimin e platformës e cila ne vazhdim do te gjeje implementim ne te gjitha komunat e Kosoves duke u fokusuar ne parametrat dhe veçoritë përkatëse ne nivel rajonal ashtu qe shkëmbimi i te dhënave, ndërveprimi i sistemeve dhe raportimet do te ofrojnë nje pasqyre sa me te qarte dhe transparente ku ky studim do te jete edhe udhërrëfyes i cili do te perdoret ne te ardhmen si mjet per implementimin e qasjes se te dhënave dhe ngritjes se efikasitetit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë ku poashtu eshte pjese e përmbushjes se standardeve te Bashkimit Evropian per Kosoven dhe ne veçanti te Ministrisë se Zhvillimit Rajonal.

1.2 Shtrirja

Gjate krijimit të raportit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar në Kosovë dhe dizajnimi i sistemit fokus kryesor i fushëveprimit janë rajonet e Kosovës, përkatësisht komunat, pastaj ministrinë ku do të bashkëveprojnë dhe mbështesin ngushte duke ofruar shërbimet nga sistemet e tyre ekzistuese elektronike të IT-se si dhe Agjencionet të cilat poashtu do mbështesin me të dhënat e tyre ku në kohe reale ose periodike do të pasurojnë sistemin tone me të dhënat e nevojshme për përgatitjen e raporteve dhe orientimit të investimeve afatshkurtera, afatmesme dhe afatgjata. Ky shkëmbim i informatave ndërmjet institucional do të realizohet duke u bazuar në bashkëpunim ndërinstytucional duke u pajtuar për proceset, gjithmonë në pajtueshmëri në ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të kësaj analize janë identifikuar këto fusha në të cilat do të duhej të vlerësohej niveli i sistemit:

1. Evidentimi i sistemeve aktuale.
2. Mënyra e tanishme e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet tyre.
3. Kërkesat e ardhshme për shkëmbim informatash ndërmjet rajoneve - komunave, agjencioneve dhe ministrive.
4. Proceset dhe shërbimet që për momentin janë të pa digjitalizuara (manuale).

1.3 Metodologjia

Duke pasur parasysh kërkesat dhe qëllimin kryesor të këtij studimi, metodologjia që është ndjekur është e bazuar në këto hapa:

- Përpilimi i listës së sistemeve dhe institucioneve kyçe në këtë projekt
- Mbledhja e informatave dhe analiza e thellë e sistemeve aktuale nga personat përgjegjës. Krijimi i pyetësorit për vlerësimin e kapaciteteve, veçorive dhe nevojave.
- Rekomandim rreth sistemeve dhe resurseve.
- Propozimi i platformave më të përshtatshme duke iu referuar rajonit dhe BE-së, theks te veçantë analiza e sistemit ndërkombëtar për zhvillimin rajonal (Inforegio - EU Regional Policy - European Commission) .
- Prezantimi dhe interpretimi i rezultateve sipas kërkesave të MZHR.
- Raportimet dhe sugjerimet nga sistemi.

1.4 Koha e Implementimit

Fazat	Pikat kryesore	Koha
Mbledhja e informatave (Faza e Parë)	<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedhja e institucioneve kyçe • Përzgjedhja e sistemeve kyçe • Zhvillimi i pyetësorëve për vlerësim 	(10 ditë)
Vlerësimi i sistemeve (Faza e dytë)	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi sipas kapaciteteve <ul style="list-style-type: none"> -Harduerike -Softuerike -Ligjore • Vlerësimi sipas mundësive vepruese • Vlerësimi sipas sigurisë së sistemit 	(10 ditë)
Dokumentimi dhe mapping i sistemeve sipas fazave 1 dhe 2 (Faza e tretë)	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentimi dhe raporti i përgjithshme (analiza e detalizuar) • Mappingu sipas infrastrukturës softuerike • Mappingu sipas rëndësisë dhe mundësive vepruese • Rekomandimi për përzgjedhjen e infrastrukturës dhe solucionit 	(10 ditë)
Zhvillimi i databazes	<ul style="list-style-type: none"> • Permbledhja e informacioneve për databazën • Krijimi i databazes sipas raportit dhe rekomandimeve • Lidhjet dhe relacionet sipas kërkesave në databazë me databazat ekzistuese për pranimin e të dhënave 	(15 ditë)
Zhvillimi i aplikacionit	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i formave në harmoni me kërkesat • Lidhjet me API apo vegzave të WEB shërbimeve (WEB Services) që mundësojnë komunikimet me aplikacionet tjera • Testimet • Publikimi 	(30 ditë)

Tabela 1. Koha e Implementimit

1.5 Akronimet dhe Shkurtesat

ABEF13	Anketa e buxhetit të Ekonomive familjare
ARBK	Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARIS	Address Registration Information System
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ASHI	Agjensioni i Shoqërisë së Informacionit
ASK	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
ASP.NET	Active Server Pages .NET
ASYCUDA	Automated System for Customs Data
AVUK	Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit e Kosovës
AZHB	Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë
BE	Bashkimi Evropian
BKS	Byroja Kosovare e Sigurimeve
BMS	Border Management System
CRM	Customer Relations Management
DB	Baza e të dhënave
DK	Dogana e Kosovës
DPD	Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve
DSHAM	Departamenti i Shtetësisë, Azilit dhe Migracionit
DVIS	Domestic Violence Information System
ICK12	Indeksi i çmimeve të konsumit
IMISH	Inspektimit dhe Monitorimi i Institucioneve Shëndetësore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPIS	Kosovo Police Information System
KRK	Kuvendi i Republikës së Kosovës
LISH	Licencimit i Institucioneve Shëndetësore
LFS	Labour Force Statistics
LMIS	Labour Management Information System
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MB	Ministria e Bujqësisë
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MS-SQL	Microsoft SQL
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OnTra	Online Tracking

PIAL	Platforma për Informim në Arsimin e Lartë
PK	Policia e Kosovës
PPIdb	Product Price Index Database
PRIMS	Police Resource Information System.
PSH	Prokuroria e Shtetit
RIMS	Resource Information Management System
SESSH	Sistemi për Evidentimin e Statistikave Shendetesore
SMEH	Sistemi për Menaxhimin e të Hyrave
SMDGJ	Sistemi për Menaxhimin e Dosjeve për Gjyqtarë
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë
SMSF	Sistemi i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik
SMRH	Sistemi i Menaxhimit të Resurseve Humane
SIMP	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit
SITK	Sistemi Informativ i Tokave Kadastrale
SPESGJ	Sistemi për Paraqitjen Elektronike në Gjykata
SMVP	Sistemi Vijueshmërisë në Punë
SMP	Sistemi Menaxhimit Projekteve
TI	Teknologjia e Informacionit
VPN	Virtual Private Network
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Tabela 2. Akronimet

1.7 Kontaktet komunale:

Komuna:	Zyrtari komunal	Drejtoria	E-maili
Deçan			
Gjakovë			
Glllogoc			
Gjilan			
Dragash			
Istog			
Kaçanik			
Klinë			
Fushë Kosovë			
Kamenicë			
Leposaviq			
Lipjan			
Obiliq			
Rahovec			
Pejë			
Podujevë			
Prishtinë			
Prizren			
Skënderaj			
Shtime			
Shtërpcë			
Suharekë			
Ferizaj			
Viti			
Vushtri			
Zubin Potok			
Zveçan			
Malishevë			
Novobërdë			
Mitrovicë e Veriu			
Mitrovicë e Jugut			
Junik			
Hani i Elezit			
Mamushë			
Graçanicë			
Ranillug			
Partesh			
Klllokot			

1.8 Kontaktet institucionale:

Artan Dreshaj, Drejtor i Departamentit për Administrim të Sistemëve dhe Komunikimëve
Ministria e Punëve të Brendshme

Mensur Maloku, Administrator i sistemit Departmenti i Teknologjisë së Informacionit
Ministria e Drejtësisë

Resim Novobërdaliu, DBA Departmenti i Teknologjisë së Informacionit
Ministria e Drejtësisë

Afërdita Thaçi, IDE Drejtore e Drejtoratit për Teknologji së Informacionit
Agjencia Kadastrale e Kosovës

Rifat Hyseni, Drejtor i Teknologjisë së Informacionit
Administrata Tatimore e Kosovës

Ilir Hetemi, Administrator i Bazave të të Dhënave
Prokuroria e Shtetit

Bekir Morina, Udhëheqës i Sektorit të Teknologjisë Informative
Dogana e Kosovës

Agim Qela, Drejtor i TI-së
Ministria e Financave

Sead Sinani, Administrator i Sistemeve Departmenti i Teknologjisë së Informacionit
Zyra e Kryeministrit

Fatmir Stublla, Administrator i Sistemeve Departmenti i Teknologjisë të Informacionit
Zyra e Kryeministrit

Shpetim Kalludra, Departmenti i Teknologjisë së Informacionit
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Vedat Macastena, Zyrtar i TI-së
Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës

Dardan Xhoshi, Administrator i Sistemeve
Agjensioni i Statistikave të Kosovës

Vullnet Kabashi, Drejtor i drejtorisë për TI

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Merita Prestreshi, Zyrtare e TI-së

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Genc Blakqori, Zyrtarë për rrjetë

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Poliksena Berisha, Zyrtare e TI-së për Komuna

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Shehadin Rustemi, Zyrtar i TI-së

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Gazmend Krasniqi, Drejtor i Departmentit të TI-së

Policia e Kosovës

Fëllanza Balaj, Drejtor

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Zenel Hisenaj, U.D.

Departamenti i Sistemit të Informacioneve Shëndetësore

Ministria e Shëndetësisë

Afërdita Arifi, Drejtoreshë e Departmentit të TI-së dhe Logjistikës

Ministria e Punëve të Jashtme

Ardian Berisha, Administrator i Bazës të Dhënave

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Mubekir Beqiri, Administrator i Rrjetit Qeveritar

Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit

Nazmi Çollaku, Zyrtar për Teknologji Informative

Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit e Kosovës

Elhami Hajdari, Zyrtar për Teknologji Informative

Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë

Teuta Sopjani, Zyrtare për Teknologji Informative

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Granit Elshani, Zyrtar për Teknologji Informative

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Bekim Hoxha, Drejtor

Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve

Abedin Mehmeti, Udhëheqës Divizioni (AFIS & SYSTEMS)

Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve

1.9 Disa nga sistemet qe do te shkëmbejmë te dhënat janë:

Sistemi \ App	URL	Përshkrimi
e-Kosova	https://ekosova.rks-gov.net/	Platforma e shërbimeve online. Platformë shtetërore ku shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike.
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	Sistemi i Gjendjes Civile te Republikës se Kosoves	Sistemi i gjendjes civile dhe pajisjes se dokumentacionit zyrtar dhe personal te qytetareve te Republikës se Kosoves.
E-Pasuria	https://e-pasuria.rks-gov.net/	Sistemi i Menaxhimit të Pasurisë ose shkurtimisht e-pasuria, është zhvilluar për nevoja të Qeverisë se Republikës së Kosovës. E-pasuria është implementuar në të gjitha ministrite, komunat, agjencitë dhe institucione të tjera të rëndësishme për shtetin e Kosovës. Përmes këtij sistemi menaxhohen të gjitha pasuritë (asetet, materialet shpenzuese, etj) të institucioneve.
e-Arkiva	https://e-arkiva.rks-gov.net/	Është zhvilluar për nevoja të institucioneve të Kosovës. Sistemi është implementuar nëpër Komuna, Ministri, Agjenci si dhe institucione të tjera të Republikës së Kosovës. Përmes këtij sistemi është krijuar arkiva elektronike e centralizuar e institucioneve tona.
Bizneset Online	https://e-bizneset.rks-gov.net/	Regjistrimi dhe Licencimi i Bizneseve Online.
Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve	https://arbk.rks-gov.net/	Sistemi elektronik per shfaqjen e te dhenave te bizneseve
Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve	https://rbk.rks-gov.net/	SISTEMI PËR REGJISTRIMIN E BIZNESEVE NË KOSOVË
Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve	https://arbk-rp.rks-gov.net/	SISTEMI PËR REGJISTRIMIN E PENGUT TE BIZNESEVE NË KOSOVË
e-Shkolla	https://e-planprogrami.rks-gov.net/User/LogOn?ReturnUrl=%2f	Dedikuar MASHT

SMIAL	MASHT	SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMATAVE TË ARSIMIT TË LARTË (SMIAL)
Sistemi i Menaxhimit të Dokumenteve	http://smd.rks-gov.net/	Është zhvilluar për nevoja të institucioneve të Kosovës. Sistemi është implementuar nëpër Komuna, Ministri, Agjenci si dhe institucione të tjera të Republikës së Kosovës. Përmes këtij sistemi është krijuar menaxhimi i dokumenteve i centralizuar në institucionet tona.
Sistemi Burimeve Njerëzore	http://simbnj.rks-gov.net/	Sistemi Burimeve Njerëzore
Shërbimi i Komunikatorit (Office Communicator 2007 R2)	http://www.rks-gov.net/sq-AL/vegeza/Pages/Communicator.aspx	Në kuadër të strategjisë për qeverisje elektronike, Institucionet e Republikës së Kosovës kanë realizuar projektin Shërbimi i Komunikatorit (Office Communicator 2007 R2).
E-Portali Shtetëror	http://www.rks-gov.net	Është zhvilluar me qëllim që të mundësojë qasje qendrore në informacionet dhe shërbimet që jepen nga institucionet qeveritare.
SMP Sistemi Menaxhimit Projekteve	http://smp/smp/	Sistemi Menaxhimit Projekteve
e-Turizmi	https://e-turizmi.rks-gov.net/LogIn.aspx?l=0	Sistemi për turizem
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	https://mshws.rks-gov.net/	Sistemi i menaxhimit të stokut farmaceutik
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	https://sessh.rks-gov.net/#/Home	Sistemi i Informimit Shëndetësor dhe raportimi i të dhënave statistikore shëndetësore
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	https://rhmsk.rks-gov.net/	Licencimi
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	https://smsf.rks-gov.net/	Sistemi i Menaxhimit të Stokut Farmaceutik për Departamentin e Burgjeve
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS	http://geoportal.rks-gov.net/	Gjeoportali
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS	https://sikt-online.rks-gov.net/Online/	Sistemi i Shërbimet Digjitale Kadastrale

1.9 Siguria

Niveli i sigurisë nga aspekti i komunikimit elektronik në kuadër të qeverisë në bazë të studimit dhe anketimit është shumë i kënaqshëm por nevojitet pa dyshim avancim më i lartë në periudhat e ardhshme të planifikimit posaqërisht në raste kur komunikimi kalon domenet e dikastereve apo Agjencioneve të caktuara për qëllim shkëmbimi informacionesh ndërmjet tyre apo edhe me qytetarët.

Në aspektin e brendshëm, Qeveria e Republikës së Kosovës posedon me domen kontrollor i cili kryen autentikimin e sigurtë për qasje në rrjetin e brendshëm në të gjitha institucionet relevante. Sa i përket aspektit të komunikimit me institucionet ndërmjet vete, përveç rrjetit të pavarur në fibër, kjo lidhje realizohet me VPN dhe në mënyrë të enkriptuar shkëmbehen informacionet.

Implementimi i politikave të sigurisë dhe procedurave të qarta të cilat do të paraqesin në formë të qartë se si individit ose entiteti arrijnë deri tek informata që i intereson në formën elektronike është e nevojshme si pjesë kryesore e aspektit të sigurisë dhe shkëmbimit ndërmjet subjekteve të administratës shtetërore. Në këtë aspekt poashtu vlen të përmendet fakti se ASHI si organ përgjegjës për organizmin e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të TI-së për Qeverinë e Republikës së Kosovës, është edhe përgjegjës për definimin e këtyre procedurave, andaj ne si Ministri sistemin elektronik për zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar do ta vendosim në serveret e ASHI-se, ku do të ketë edhe sigurinë e mjaftuar nga tentimet e keqperdorimeve të web aplikacionit dhe logimet e pautorizuara si pjesë e autorizimit në sistem duke përdorur përdorues dhe password të fortë për të cilin do të arrihet një komunikim i plotësisht i besueshëm.

Sistemi elektronik për zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar duhet të jetë në përputhje me plotë me rregulloren për zhvillimin e aplikacioneve në nivel shtetëror dhe do të skanohet paraprakisht nga ekspertet e ASHI për pershtatshmerinë dhe pranueshmerinë e vendosjes në serveret e tyre.

Sistemi duhet të:

